



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE
Nr. 11384
Datë, më 15.06.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 1737 Prot.

Vlorë, më 10/06/2026

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Aseteve dhe Burimeve Mbështetëse

Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit Help Desk

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të dy akteve administrativ – (bashkëngjitur) si vijon :

- Vendimin e kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.139, me Nr.3794/2 Prot., datë 31/12/2025, i materializuar për subjektin “Mirand Qejvanaj” p.f, me NID K00907057C, me banim në Njësia Administrative Horë – Vranisht, fshati Kallarar.
- Vendimin e Sekuestros Nr.1549 Prot., datë 28/05/2026, i materializuar për subjektin “Erind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, me banim në Vlorë (Selenicë; Njësia Administrative Armen; fshati Picar, Rruga Bregut, ND.26, Hyrja 1, KP 9409).

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.3794/2 Prot.

Vlorë, më 31/12/2025

V E N D I M N r . 1 3 9

Sot, më datë 31/12/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces Verbalin e verifikimit të kundërvajtjes administrative me nr.serial 0032855, Nr.3794/1 Prot., datë 29-12-2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Mirand Qejvanaj” p.f, me NID K00907057C, me banim në Vlorë,

K O N S T A T O V A S E :

Në Degën e Doganës Vlorë, është paraqitur subjekti “Mirand Qejvanaj”, i përfaqësuar nga agjensia doganore “Gad.Universi” me kod J 102, i cili ka kërkuar mbylljen e deklarimit të tranzitit të mallit (deklarata #9, dt.24.12.2025). Më tej, nga ana e subjektit është kërkuar ushtrimi i kontrollit paraprak të ngarkesës së mallit, ndodhur në mjetin e transportit me targa AB140UN. Nga ana e Zyrës së Operacioneve Doganore është proceduar sipas kërkesës së subjektit, ku mbas kontrollit të ushtruar, kanë mbajtur Proces verbalin e konstatimit. Më tej, nga ana e grupit të kontrollit, është mbajtur proces verbali i verifikimit të kundërvajtjes administrative Nr.3794/1 Prot., datë 29.12.2025, i cili është nënshkruar pa rezerva nga subjekti.

Nga ana e grupit të punës, në proces verbalin e verifikimit të kundërvajtjes administrative Nr.3794/1 Prot., datë 29.12.2025, është kryer përshkrimi i shkeljes doganore si vijon : “Në bazë të kërkesës paraprake të bërë nga individ i Mirand Qejvanaj me nr. Id K00907057C për rishikim të peshës totale mes T1#9 datë 24/12/2025 me destinacion doganëne Vlorës dhe deklarimit të kryer me DAV R 18107. Pavarsisht kërkesës paraprake për rishikim të peshës totale dhe deklarimin e saktë në zyrën e destinacionit. Subjekti do të penalizohet në bazë të neneve 250/1/a dhe 256/1/b të Kodit Doganor për parregullsi dokumentacioni.

Në përfundim, pas shqyrtimit të materialit të lartpërmendur, arrita në konkluzionin se nga ana e subjektit është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në dispozitat e Kodit Doganor. Për sa më lart, mbështetur në nenet 250/1/a, 251, 256/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

- Subjekti “Mirand Qejvanaj” p.f, me NID K00907057C, të penalizohet në shumën 20.000 (Njëzetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës & Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Mirand Qejvanaj” p.f, me NID K00907057C, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i R.SH” (i ndryshuar).

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1549..... Prot.

Vlorë, më 28/05/2026

VENDIM SEKUESTRO

“Për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor që debitori - subjekti “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, me banim në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.23, me Nr.98/5 Prot., datë 09/03/2026, ka vendosur kontabilizimin e penaltetit doganor në shumën 150.000 (Njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, ndaj subjektit debitor “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, me banim në Vlorë (Selenicë; Njësia Administrative Armen; fshati Picar, Rruga Bregut, ND.26, Hyrja 1, KP 9409).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.826 Prot., datë 18/03/2026 me lëndë “Njoftim - Vendimi”, me shkresën nr.826/1 Prot., datë 25/03/2026 me lëndë “Rinjofitim - Vendimi”, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Subjekti debitor “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 23, me Nr.98/5 Prot., datë 09/03/2026, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.23, me Nr.98/5 Prot., datë 09/03/2026, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, subjektit - “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, subjekti “Erlind Hasanaj” p.f me NID J50416050D, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 150,000 (Njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.23, me Nr.98/5 Prot., datë 09/03/2026, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj

